



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 16 prot.

Kamëz, më 24. 2.2025

V E N D I M

Nr. 14 .Datë 24/2 2025

MBI

**“DHËNIE NDIHME EKONOMIKE PËR FAMILJET NË NEVOJË NGA
BUXHETI I BASHKISË DHE NGA FONDI 6% I BLOK -NDIHMËS EKONOMIKE”**

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 24.02.2025, pasi mori në shqyrtim Projekt-vendimin Nr.13 Datë 20.02.2025, në mbështetje të nenit 24, , të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 57/2019, datë 18/07/2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë” neni 21, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 597 datë 04/09/2019 kreu 4 pika 3, për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike, Vendimin nr. 617 datë 22.09.2022, vendimin nr.855 datë 29.12.2024 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, neni 4, neni 5, neni 6 të ligjit nr. 121/2016 “Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të vendimit të Këshillit Bashkiak Kamëz nr.119 dt 19.12.2024 “ Mbi detajimin e buxhetit për vitin 2025, 2026, 2027”; VKB nr. 10 datë 24.01.2025 mbi “Miratimin e kriterëve për trajtimin me ndihmë ekonomike për familjet në nevojë nga buxheti i bashkisë për vitin, 2025”, Këshilli Bashkiak Kamëz”;

V E N D O S I:

1. Miratimin e përdorimit të të ardhurave të bashkisë për ndihmë ekonomike për 197 familje me një fond prej 1,388,000 (njëmiljon e treqind e tetëdhjetë e tetëmijë) lekë për muajin Shkurt 2025. Fondi do të përballohet sipas strukturës buxhetore Gr 0, prog., 10430, Kap.5, Art 606.
2. Listën e muajit Janar 2025, prej 64 familje që janë rekomanduar nga administratorët shoqërorë për fondin 6% të bllok-ndihmës ekonomike. Fondi për këto familje është 375,793 (treqind e shtatëdhjetë e pesëmijë e shtatëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë.
3. Bashkëlidhur këtij vendimi gjeni listën e ndihmës ekonomike për rastet e veçanta dhe listën e rekomanduar në fondin 6% të bllok-ndihmës ekonomike.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimit të nenit 55, pika 6, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

KRYETAR KËSHILLI
Hysen KOLDASHI

